


	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	--	--

Datë/a:	17.09.2018.
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: N.T. - "BITI-COM", adresa: "Lupç i Poshtëm" Podujevë
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës 

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.06.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Lulishnja "BUÇAJ" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës**", me Nr. të Prok: 616 18 007 111 nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.T. - "BITI-COM", e parashtruar me datë: 13.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës**", me Nr. të Prok: 616 18 007 111, kundër *Njoftimit për Vendim për dhënie* të AK -së, të datës 11.09.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës**", me Nr. të Prok: 616 18 007 111 dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës ;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 16.05.2017 ka pranuar vendimin nga Organi Shqyrtues i Prokurimit pas ankesës së parashtruar nga OE: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k. kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me tenderin me titull: **"Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës"**, me Nr. të Prok: 616 18 007 111.

Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) konstaton pranimin e ankesës së Operatorit Ekonomik të lartcekur dhe rikthen lëndën në rivlerësim si dhe udhëzon Operatorin Ekonomik që ti përmbahet kriterëve të dosjes së tenderit.

Autoriteti Kontraktues në bazë të vendimeve nr.137/18 dhe 255/18 të OSHP-së për rivlerësim të ofertave ka propozuar për dhënie të kontratës OE: Lulishtja "BUÇAJ" sh.p.k. me datë 11.09.2018.

Me datë 13.09.2018 përfaqësuesi i OE: N.T. - "BITI-COM", ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim kundër Vendimit të AK-së të datës 11.09.2018.

I. Baza Ligjore për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim

Operatori Ekonomik: N.T. - "BITI-COM" ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me datë 13.09.2018 të protokoluar dhe dorëzuar në mënyrë fizike tek Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës

Provë 1: Kërkesa për Rishqyrtim – datë 13.09.2018

Autoriteti Kontraktues me datë 11.09.2018 iu ka dërguar letrat standarde i sukseshëm, i pasukseshëm, i eliminuar OE ekonomik, ndërsa po me atë datë 11.09.2018 ka bërë njoftimin e Vendimit për dhënie të kontratës.

Provë 2: Letër Standarde për OE ankimor dhe OE të rekomanduar për dhënie të kontratës

Provë 3: Njoftimi i Vendimit për dhënie të kontratës 11.09.2018.

III. Pretendimet e OE: N.T. - "BITI-COM" lidhur me shkeljen e dispozitave të LPP-së, konkretisht shkeljen e pikës 9.1 seksioni II i dosjes së tenderit.

OE - Ankimor: N.T. - "BITI-COM" thekson si në vijim: "Ne si OE mendojmë se AK KK PRISHTINË ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së pasi që ne kemi plotësuar të gjitha kushtet e parapara dhe sipas dispozitave të LPP-së, pra te pika 9.1 seksioni II ku AK mendon se nuk i kemi plotësuar kushtet sepse ne kemi ofruar çertifikat fitosanitare edhe për bimë dekorative dhe mund ta vërtetojmë prapë nëse nevojitet.

II. Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Autoriteti Kontraktues në bazë të vendimeve 137/18 dhe 255/18 të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) si dhe në bazë të respektimit të nenit 9.1 të seksionit II të dosjes së tenderit ka bërë ri-vlerësimin e ofertave ku në vendimin 137/18 të nxjerrur nga OSHP decidivisht thekson:

"OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë fito-sanitare e cila është për dhe (substrat) dhe nuk ka treguar prejardhjen se drunjtë janë me prejardhje nga BE, ndërsa ky aktivitet ka të bëjë me furnizim me drunjë dekorativ e jo furnizim me dhe.

Autoriteti Kontraktues në bazë të vendimit 255/18 të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) si dhe në bazë të respektimit të nenit 9.1 të seksionit II të dosjes së tenderit ka bërë ri-vlerësimin e ofertave ku në vendimin 255/18 të nxjerrur nga OSHP decidivisht thekson:

"Duke pasur parasysh që autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë OE "NT "BITI-COM" (sikurse herën e parë), edhe me pse me vendimin e OSHP-së Nr.137/18 ishte konstatuar që është i papërgjegjshëm".

Autoriteti Kontraktues duke marrë parasysh vendimin 137 dhe vendimin e fundit nr.255/18 të obliguar nga OSHP si organ i shkallës më të lartë vendos në respektimin e këtij vendimi në bazë të ri-vlerësimit të ofertave duke shpallur të papërgjegjshme ofertën e OE: NT "BITI-COM" gjithnjë sipas vendimit të OSHP-së.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit